



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI**

Handwritten signature and date: 29.03.2002

KOMISIONI PER CESHTJET KUSHTETUESE DHE LIGJORE

RELACION

Për dekretin nr. 3061, dt. 14.06.2001 te Presidentit te Republikes “Për kthimin e ligjit nr. 8811, dt. 17.05.2001 “Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Larte te Drejtesise”

Komisioni i Ligjeve, ne mbledhjen e dates 27.03.2002, mori ne shqyrtim dekretin e Presidentit te Republikes “Për kthimin e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Larte te Drejtesise”.

Komisioni u njoh me motivet e kthimit te ligjit nga Presidenti dhe pasi degjoi shpjegimet e ministrit te Drejtesise dhe Drejtorit te Përgjithshem te Legjislacionit, e vleresoi qe ishte e drejte qe nenet ne 16 dhe 31 te ketij ligji te behen riformulimet e nevojshme me qellim qe te shmangen ato formulime qe krijojne dyzime lidhur me disa parime te Kushtetutes dhe te ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqesor ne Republiken e Shqipërise”.

Pra Komisioni i konsideroi te drejta verejtjet e dekretit te Presidentit për nenet 16 dhe 31 dhe mendon qe ne keto nene te behen formulimet e meposhtme:

1. Ne nenin 16 :

- Ne piken 1 te ketij neni, ne shkronjen “a”, ne fjaline e pare, fjalet “ose i dergon Ministrit te Drejtesise per trajtim”, te hiqen.

Gjithashtu,, ne fjaline e fundit te kesaj shkronje, fjalet “te cilat gjykohen prej tij per t’u ndjekur nga Inspektorati i Keshillit te Larte te Drejtesise” zevendesohen me fjalet “qe kane te bejne me ceshtjet e parashikuara ne shkronjen “dh” dhe “e” te ketij neni.”

- Pika 2 e ketij neni te riformulohet si vijon :

16

“Inspektorati i Keshillit te Larte te Drejtesise dhe Ministri i Drejtesise, kryesisht apo ne zbatim te detyrave te lena nga Keshilli i Larte i Drejtesise, kryejne verifikime dhe inspektime te perbashketa. Ne kete rast, raportimi dhe nismat per procedimin disiplinor te gjyqtareve, propozohen ne Keshillin e Larte te Drejtesise nga Zevendeskryetari.”

2. Ne nenin 31

Ne nenin 31, pika 6, te riformulohet si vijon :

“Ministri i Drejtesise eshte i detyruar qe, Brenda 15 diteve nga depozitimi i kerkeses, te njoftoje Zevendeskryetarin e Keshillit te Larte te Drejtesise, per rastet dhe motivet e mosfillimit te procedimit disiplinor te gjyqtarit ne kushtet e shkronjes “a” dhe “c”, pika 1 e nenit 16 te ketij ligji. Zevndeskryetari, kryesisht, nese çmon te pamjaftueshme motivet e parashtruara nga Ministri i Drejtesise, propozon procedimin disiplinor te gjyqtareve para Keshillit te Larte te Drejtesise. Ne kete rast, Zevendeskryetari i Keshillit te Larte te Drejtesise, nuk merr pjese ne votim.”

3. Ne nenin 39:

Behen keto ndryshime për efekt te saktësisë nga e teknikes legislative qe vijne si rezultat i ndryshimeve te mesipërme. Keto nuk prekin përmbajtjen e ketij neni.

Neni 39

Shfuqizimi

1. Ne ligjin nr. 8436, dt. 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqesor ne Republiken e Shqipërisë” shfuqizohen:

Neni 17,

Neni 20, paragrafi i fundit,

Neni 22, paragrafi i pare dhe i dyte,

Neni 24 paragrafi i dyte,

Neni 28, paragrafi i fundit,


Neni 44, paragrafi i gjashte,

Neni 45, paragrafi i trete.

(Pika 2 nuk ka ndryshime)

Spartak BRAHO

KRYETAR



Shqipëri
29.03.2002